REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:249140

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05386836

2021:249141

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal- Gjyqtarja Hakile Ilazi me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Idrizi duke vendosur lidhur me aprovimin e Marrëveshjes së Ndërmjetësimit me Nr.ref. i nd: 80/2024 e datës 27.02.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të akuzuarit H.S. dhe të dëmtuarit - Perfaqesuesit ligjore te KEDS-it Qëndrim Sallahu, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr..../21 të dt.05.11.2021, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. Nr.06/L-009, më datë 28.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. **APROVOHET** Marrëveshja e Ndërmjetësimit me Nr.ref. i nd: ../2024 e datës 27.02.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të akuzuarit H.S. me venbanim në G..të Poshtëm dhe të dëmtuarit - Perfaqesuesit ligjore te KEDS-it Qëndrim Sallahu me autorizim, Distrikti Ferizaj.

II. **HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1686/21 të dt.05.11.2021 dhe **PUSHON** procedura penale kundër të akuzuarit H.S. shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

III. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

2021:249141

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.1686/21 të dt.05.11.2021, e ka ngarkuar të akuzuarit H.S. për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Me pëlqimin e të dëmtuares, prokurorit të shtetit Mimoza Syla Hyseni dhe të akuzuarit të dhënë në shqyrtim fillestar të dt. 27.02.2024, duke vepruar konform nenit 8 par.1, 2 dhe par.7 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datën 27.02.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja në mes palëve në procedurë për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit H.S. dhe të dëmtuarit - Perfaqesuesit ligjore te KEDS-it Qëndrim Sallahu me autorizim, Distrikti Ferizaj.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoi se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Andaj, duke u bazuar në provat si më lart dhe në bazë të nenit 248 par.1 nënpar.1.4 të KPPK-së, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

2021:249141

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
2021:249141 me datë 28.02.2024

Gjyqtarja
Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej 3 (tre) ditëve, nga dita e dorëzimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit Kosovës, përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.